



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

BASHKIA VAU DEJES SHPALL

Thirrjen Publike për zgjedhjen e një përfaqësuesi të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) në Komisionin e Vlerësimit, të aplikimeve për Thirrjen e hapur publiketë organizatave të shoqërisë civile (OSHC).

Një nga objektivat e Bashkisë është bashkëpunimi me shoqërinë civile, me qëllim realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Vau Dejes.

Për të siguruar një proces transparent dhe të hapur të përzgjedhjes së projekteve të OSHC-ve, Bashkia Vau Dejes shpall Thirrjen Publike për praninë e një përfaqësuesi të OSHC-së në Komisionin e Vlerësimit të aplikimeve të OSHC-ve në Bashkinë Vau Dejes.

Përfaqësuesi i OSHC-së në Komisionin e Vlerësimit do të ketë këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Përfaqësuesi i OSHC-ve do të jetë anëtar i Komisionit të Vlerësimit me të drejtë vote, dhe do të kryejë vlerësim;
2. Përfaqësuesi i OSHC-ve duhet të marrë pjesë në Komisionin e Vlerësimit nga fillimi deri në fund të procesit;
3. Përfaqësuesi i OSHC-ve do të nënshkruajë një deklaratë konfidencialiteti dhe paanshmërie;
4. Përfaqësuesi i OSHC-ve do të nënshkruajë bashkërisht me anëtarët e tjerë raportin e Komisionit të Vlerësimit dhe do të konfirmojë gjetjet e dalura nga procesi, si dhe do të japë komente shtesë lidhur me punën e Komisionit të Vlerësimit, nëse dhe kur është e nevojshme.

Të interesuarit për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit duhet të jenë anëtarë të OSHC-ve të themeluara/regjistruara në Shqipëri dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Përvojë dhe aftësi të mëparshme në kryerjen e një vlerësimi të paanshëm, të drejtë dhe transparent të projekt propozimeve të OSHC-ve. Përvoja me skemat e dhënies së granteve të BE-së do të konsiderohet si përparësi;
2. Përvojë në përgatitjen dhe/ose zbatimin e projekteve të financuara nga fondet publike, sidomos në nivel vendor;
3. Njohja e bazës ligjore, dokumenteve strategjike, politikave dhe metodologjive në fushën e dhënies së fondeve publike për OSHC-të;
4. Njohja e parimeve të Ciklit të Menaxhimit të Projekteve (PCM);
5. Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze në të folur dhe të shkruar.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim në adresën: info@vaudejes.gov.al

- CV (duke specifikuar përvojën e mëparshme në fushat e sipërpërmendura);
- Letër Motivimi (duke shprehur interesin për pjesëmarrje në Komisionin e Vlerësimit, si dhe konfirmimin e disponueshmërisë për procesin e vlerësimit;

Përfaqësuesi i OSHC-së do të kontraktohet nga Bashkia Vau Dejes me kontratë shërbimi. Përfaqësuesi i OSHC-së duhet të jetë i disponueshëm për angazhimin në Komision e Vlerësimit (**4-5 ditë**) gjatë periudhës **Nëntor – Dhjetor 2022**.

OSHC-të nga e cila kandidati i përzgjedhur për Komisionin e Vlerësimit është anëtar dhe/ose punonjës NUK do ketë të drejtë të aplikojnë (as si aplikues kryesor as si OSHC partnere) në thirrjet publike për dorëzimin e projekt propozimeve të OSHC-ve.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data **17/11/2022**, ora **16:00**. Për informacion të mëtejshëm, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni në adresën info@vaudejes.gov.al